**Përmbledhje e kontratës**

- Kjo përmbledhje e kontratës përmban elementët kryesorë të kësaj oferte të shërbimit sipas kërkesave të Ligjit 54/2024[1]
- Ky informacion lehtëson krahasimin midis ofertave të shërbimit.
- Informacion i plotë për shërbimin jepet në dokumenta të tjerë.

| | |
|---|---|
| Shërbimi/shërbimet dhe pajisje fundore | **Shërbim internet nëpërmjet Paketave OfficeNet për segmentin biznes.**<br><br>Pajisjet OfficeNet i jepen pajtimtarit në përdorim. |
| Çmimi | (see table below) |
| Shpejtësitë e aksesit në internet dhe mjetet juridike të ankimit/zgjidhjes së mosmarrëveshjeve | Ankesat mund të paraqiten: nëpërmjet numrave 142 dhe 123 për të gjitha llojet e ankesave, nëpërmjet sporteleve të One Albania ku merret deklarim shkresor për ankesën, nëpërmjet postës drejtuar në adresën zyrtare të One Albania, për të gjitha llojet e ankesave me email në adresën ankesa-zyrtare@one.al në përputhje me Udhëzues për Zgjidhjen e Ankesave, publikuar https://www.one.al/sites/default/documents/files/inline-files/Aneksi%20nr.2%20Udhezues%20per%20zgjidhjen%20e%20ankesave_1.pdf.<br>*Në rast se shërbimi i kontraktuar nuk plotëson nivelin e cilësisë së parashikuar në kontratë dhe/ose Operatori vonon riparimin e defekteve në rrjetin e tij të telekomunikacioneve, tej afateve të përcaktuara në këtë Kontratë, atëherë ai detyrohet t'i zbresë nga fatura e muajit në vijim tarifën e pajtimit në proporcion me ditët në mungesë cilësie/vonese riparimi defekti* |
| Kohëzgjatja, rinovimi dhe përfundimi | - Në cdo kohë pas afatit fillestar 12/24 muaj pajtimtari mund të rinovojë kontratën.<br>- Në rast zgjidhjeje të parakohshme të kontratës, Pajtimtari paguan tarifën mujore të plotë, proporcionalisht për periudhën e mbetur të afatit.<br>- Në rastet kur pajtimtari vendos zgjidhje të parakohshme të kontratës atëherë duhet te paguajë si penalitet vlerën e pajtimeve mujore për periudhën e mbetur të kontratës.<br>- Të gjitha pajisjet e dhëna Pajtimtarit nga ONE janë pronë e ONE dhe i jepen në përdorim. Pajtimtarit për të gjithë kohëzgjatjen e shërbimit.<br>- Pajtimtari do të konsiderohet përgjegjës për dëmet e mundshme apo moskthimin e pajisjeve dhe si penalitet do të paguajë vlerën prej 6,000 lekë për këtë pajisje. |
| Informacione të tjera të rëndësishme | - Për OfficeNet Advance 4G, vëllimi i internetit me shpejtësi 4G/4G+ është 500 GB.<br>- Për OfficeNet Unlimited 5G, vëllimi i internetit me shpejtësi 5G është 2 TB.<br>- Përllogaritja e konsumit të internetit do të bëhet cdo 100 KB.<br>- Pas konsumimit të GB të përfshira në paketë, pajtimtari do të vazhdojë lundrimin në internet por me shpejtësi të kufizuar (256 kbps).<br>- Njësitë GB nuk janë të vlefshme për t'u përdorur në Roaming.<br>- Maksimumi i zonave të lejuara për OfficeNet është 5 zona. Aktivizimi i 2 zonave të para është falas, 3 zonat shtesë janë me një pagesë prej 300 lekë/zonë.<br><br>**Ky dokument është publikuar në datë 1 Maj 2026.** |

Çmimi:

| Planet OfficeNet | Shpejtësia Internet deri në (shkarkim/ngarkim) | Pajtimi Mujor (Lekë, me TVSH) |
|---|---|---|
| OfficeNet Advance 4G | 300 Mbps / 50 Mbps | 1,320 |
| OfficeNet Unlimited 5G | 2 Gbps / 150 Mbps | 2,500 |

1 Pika 5 e Nenit 141 të Ligjit 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", e cila është përafruar plotësisht me Nenin 102 (3) të Direktivës (BE) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 dhjetor 2018, që përcakton Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike (OJ L 321, 17.12.2018, f. 36)